



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

### NJOFTIM PËR MEDIA

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka zhvilluar ditën e premte, më 22.04.2022, mbledhjen plenare të radhës, në prani të gjithë anëtarëve të Këshillit si dhe të ftuarëve përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë dhe Programi OPDAT.

Nën drejtimin e kreut të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zotit Alfred Balla, mbledhja ka nisur me miratimin e proces-verbalit të seancës plenare të datës 13.04.2022.

Më pas, përmes praktikës së caktimeve të përkohshme, Këshilli ka vendosur unanimisht miratimin e projekt-akteve për caktimet e përkohshme në pozicionin Prokuror për zonjën Elidjana Kasa, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Ndërkohë, me 8 (tetë) vota pro, 1 kundër (z.Sokol Stojani) dhe në mungesë të zotit Zeqir Hoda, pas deklarimit të konfliktit të interesit nga ana e tij, Këshilli miratoi edhe projekt-aktin për caktimin e përkohshëm në pozicionin Prokuror, të zotit Kujtim Basha, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Në vijim, janë miratuar unanimisht caktimet e përkohshme për katër (4) Drejtues të zyrave të prokurorive si vijon;

- Miratimi i projekt – aktit për caktimin e përkohshëm të zotit Asllan Bajramaj, në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet.;
- Miratimin e projekt – aktit për caktimin e përkohshëm të zotit Kledian Llaho, në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë;
- Miratimin e projekt – aktit për caktimin e përkohshëm të zotit Aurel Zarka, në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë;
- Miratimin e projekt – aktit për caktimin e përkohshëm të zotit Moisi Duda, në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, Këshilli vendosi unanimisht të miratojë projekt-aktin për mbarimin e statusit të magjistratit për zotin Brahim Dragjoshi, prokuror pranë Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Shkodër si dhe pranimin e kërkesës dhe miratimin e qëndrimit në detyrë të magjistratit z. Thoma Jano, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç.

Gjithashtu, në mënyrë unanime është miratuar edhe projekt-akti për një ndryshim në vendimin nr. 228, datë 13.07.2021, të Këshillit “Për praktiken profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës” i ndryshuar, duke zëvendësuar tek aneksi 2, emrin e prokurores zonja Eriselda Bala me zonjën Rovena Bozo.

Më pas, mbledhja ka vijuar me miratimin unanim të dy (2) ‘Raporteve të analizimit të aftësisë profesionale të subjekteve të rivlerësimit, zotit Kudus Shahu dhe zotit Bajram Breçani’.

Në përfundim, është hedhur shorti për caktimin e relatorit në lidhje me procedurën për ngritjen në detyrë të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, nga i cili është përzgjedhur anëtari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, zoti Bujar Sheshi.

Për t’u njohur me publikimin audio të seancës së sotme, ju lutemi klikoni [këtu](#).